



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 03, Datë 10.01.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN AVENUE”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, NË
POVELÇË, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.01.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 27/1 prot., datë 06.01.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SUN AVENUE” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Povelçë, Bashkia Fier”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 321, datë 12.12.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SUN AVENUE” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për arsye të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Me shkresën nr. 1770/3 prot., datë 25.10.2022, u njoftua shoqëria për këtë vendimmarrje dhe iu bë me dije dokumentacioni i munguar. Po ashtu në këtë shkresë ERE ka informuar shoqërinë se, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7 të rregullores së licencimit, në

rast se do të aplikonte, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijëni e vendimit për mosfillimin e procedurës, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Në përgjigje të shkresës së ERE-s shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2014/2 prot., datë 15.12.2022, ka përcjellë dokumentacionin që lidhet me aplikimin.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të Aneksit A të Rregullores.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “SUN AVENUE” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c” për pikën 2.1, gërmat “a”, “b”, “c”. “d”, “e” dhe “f” .
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se mungon një pjesë e dokumentacionit si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

- *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*
- **gërma “c”**: Nuk rezulton që shoqëria të ketë depozituar dokumentacion në kuadër të mbështetjes financiare, ndaj vlerësohet që pas fillimit të procedurës t’i kërkohet të depozitojë në ERE dokumentacionin vërtetues të aftësisë financiare të realizimit të projektit, referuar përcaktimeve të planit të biznesit, ku parashikohet që investimi do të bëhet 30% me financim të ortakëve dhe 70 % me kredi bankare.
- Shoqëria “SUN AVENUE” sh.p.k. duhet të informojë ERE-n mbi arsyet pse parashikon që operimi i veprës do të fillojë 4 muaj (01.05.2024) pas ndërtimit të saj (viti 2023).
- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga se nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SUN AVENUE” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI